



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 17740 Prot

Shkodër, më 4.9.2024

Lënda: Dërgojmë projekt-vendim dhe relacion.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër

Të nderuar këshilltarë!

Bashkëlidhur dërgojmë projekt-vendim dhe relacion, “Për caktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe, në territorin e Bashkisë Shkodër”.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR

Bënet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ prot.

Shkodër, më ____ . ____ . 2024

PROJEKT - VENDIM

Nr _____, datë ____ . ____ . 2024

**“PËR CAKTIMIN E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE TARIFAVE
TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË DHE
SHESHE, NË TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR”.**


Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës ____ / ____ / 2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 23, pika 14, neni 54/germa k; Ligjin nr.8378, date 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 3 pika 28, neni 7 e vijues; Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar neni 14, neni 15; Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr.89, datë 22.12.2022 “Për policinë bashkiake”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.153, datë 07.04.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Udhëzimin nr.7, datë 10.06.2008 “Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë”; Paketa Fiskale e Bashkisë Shkodër, si dhe pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga grupi i punës ngritur me Urdhërin nr.998, datë 08.07.2024, “Për ngritjen e grupit të punës me qëllim studimin dhe caktimin e vendparkimeve të automjeteve që do të bëhen me pagesë në rrugët/sheshet publike dhe tarifën që caktohet për to, në territorin e Bashkisë Shkodër”;

VENDOSI:

1. Miratimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe publike të territorit administrativ të bashkisë Shkodër, sipas listës dhe planvendosjes pjesë integrale e vendimit.
2. Shërbimi i parkimit me pagesë në rrugë është shërbimi i ofruar për rregullimin e parkimit të automjeteve në qytetin e Shkodrës dhe në zonën e plazhit të Velipojës, ku qëndrimi i automjeteve kushtëzohet nga pagesa e një tarife, që varet nga kohëzgjatja e qëndrimit në parkim.
3. Miratimin e rrugëve dhe shesheve publike të Bashkisë Shkodër si dhe fashat orare ku do të realizohet shërbimi i parkimit me pagesë.

4. Identifikimi i zonave të parkimit me pagesë në rrugët dhe sheshet publike, do të bëhet nëpërmjet vijëzimit me ngjyre BLU dhe/ose tabelave vertikale sinjalizuese për rrugët e destinuar për shërbimin e parkimit me pagesë.
5. Administrimi i shërbimit të parkimit me pagesë të kryhet drejtpërdrejt nga struktura përkatëse e Bashkisë Shkodër ose nga një subjekt privat i përzgjedhur nga bashkia, me të cilin mund të lidhë një kontratë shërbimi dhe/ose të krijojë një shoqëri tregtare të përbashkët, ose të zgjedhë çdo formë tjetër bashkëpunimi që lejon legjislacioni në fuqi.
6. Përfshihen nga pagesa vendparkimet e personave me aftësi ndryshe, vendparkimet e ambulancës, si dhe zjarrfikëseve.
7. Miratimin e Aneksit nr.1, për rrugët dhe sheshet publike në të cilat do të ofrohet shërbimi i parkimit me pagesë.
8. Miratimin e Aneksit nr.2, për kohën e funksionimit të parkingut me pagesë dhe tarifës përkatëse.
9. Ngarkohet me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi Drejtoria e Përgjithme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit; Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar; Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore; Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike dhe Drejtoria e Policisë Bashkiake, në Bashkinë Shkodër.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.


Zv. Kryetar
Onid BEJLERI



Drejtorja e Përgjithshme Juridike Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
Denis LESHA



Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit
të Territorit
Lulzim MASHI




Drejtorja Juridike
Brikena LEQEJZA




Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar

Teuta HAXHI



Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore

Haki Bilali




ANEKSI NR. 1

Rrugët dhe sheshet publike në të cilat do të ofrohet shërbimi i parkimit me pagesë

<u>Rrugët dhe sheshet</u>	<u>Specifikimi i rrugëve në terren</u>
1. Bulevardi “Zogu i I-rë”.	Segmenti nga/përfshirë sheshi “Parrucë” deri në sheshin “Balshaj”, krahu i djathtë, si dhe përfshirë një pjesë të shkurtër të krahut të majtë, që aktualisht është parkim publik.
2. Rruga “Studenti”.	Segmenti nga Sheshi “Parrucë” deri/përfshirë sheshin “Demokracia”, në të dy krahët.
3. Rruga “Qemal Draçini”.	Segmenti nga sheshi “Demokracia” deri në fillimin e Rrugës “Martin Camaj”.
4. Rruga “Martin Camaj”.	Segmenti i rrugës “Martin Camaj” deri/përfshirë Sheshin “Rus i Madh”, në të dy krahët.
5. Rruga “Vilson”.	Nga Sheshi “Nënë Tereza” deri në Sheshin “2 Prilli”, përfshirë sheshin para vendit të quajtur “Salla e lojërave”, në njërin dhe të dy krahët, sipas sinjalistikës.
6. Bulevardi “Skënderbeu”.	Segmenti nga sheshi “Nënë Tereza” deri në degëzimin me rrugën “Arra e Madhe”, në të dy krahët.
7. Bulevardi “Bujar Bishanaku”.	Segmenti nga sheshi “Demokracia” deri në degëzimin me rrugën “Hodo Beg Sokoli”, në të dy krahët.
8. Vendparkimi aktual nr.1, në hyrje të Shirokës.	Vendparkimet aktuale deri te ndërtesa e OMP-së.
9. Vendparkimi nr.2, në dalje nga qendra e Shirokës.	Parkingu që do të ndërtohet në dalje të Shirokës.
10. Vend parkimi aktual publik nr.1, në qendër të Velipojës.	Vendparkimi djathtas rrugës ” Ura e Gjon Lulit (plazh)”
11. Vend parkimi aktual publik nr.2, rrugën “Pashko Selita”.	Vendparkimi përballë zyrave të MZSH-së, Velipojë.

HARTA E RRUGËVE ME PAGESË NË QYTETIN E SHKODRËS



HARTA E SHESHEVE ME PAGESË NË SHIROKË

Vendparkimi aktual nr. 1 në qendër të Shirokës



Vendparkimi nr. 2 që do të ndërtohet të sheshi në dalje nga qendra e Shirokës (foto e projektit)



HARTA E SHESHEVE ME PAGESË NË VELIPOJË



ANEKSI NR. 2

Koha e funksionimit të parkingut me pagesë do të jetë 50 (pesëdhjetë) lekë/orë për autoveturat në zonat e vendparkimeve dhe 300 (treqind) lekë/orë për autobuzët vetëm në zonën vendparkimit me pagesë të Shirokës, sipas tabelës me poshtë:

Zona e vendparkimeve me pagesë	Orari i funksionimit	Periudha e shfytëzimit
1. Bulevardi "Zogu i I-rë".	08:00 – 16:00	Vjetore (E Hënë- E Premte)
2. Rruga "Studenti".	08:00 – 16:00	Vjetore (E Hënë- E Premte)
3. Rruga "Qemal Draçini".	08:00 – 16:00	Vjetor (E Hënë- E Premte)
4. Rruga "Martin Camaj".	08:00 – 16:00	Vjetore (E Hënë- E Premte)
5. Rruga "Vilson".	08:00 – 16:00	Vjetore (E Hënë- E Premte)
6. Bulevardi "Skënderbeu".	08:00 – 16:00	Vjetore (E Hënë- E Premte)
7. Bulevardi "Bujar Bishanaku".	08:00 – 16:00	Vjetore (E Hënë- E Premte)
8. Venparkimi aktual publik nr. 1,në hyrje të Shirokës.	10:00 – 22:00	Vjetore (E Hënë- E Dielë)
9. Vendparkimi nr. 2, në dalje nga qendra e Shirokës.	10:00 – 22:00	Vjetore (E Hënë - E Dielë)
10. Vend parkimi aktual publik nr.1, në qendër të Velipojës.	00:00 – 00:59	01.06 – 31.08 (E Hënë - E Dielë)
11. Vend parkimi aktual publik nr.2, në rrugën "Pashko Selita".	00:00 – 00:59	01.06 - 31.08. (E Hënë - E Dielë)

Shenime:

- Tarifa prej 50 (pesëdhjetë) lekë/orë për autoveturat është miratuar sipas VKB nr.1 dt.22.01.2016 "Për taksat dhe tarifat vendore në bashkinë Shkodër" të ndryshuar, kreu III "Tarifa vendore", pika 4.4.2.
- Tarifa prej 300 (treqind) lekë/orë për autobuzët vetëm në vendparkimet e Shirokës do të zbatohet me ndryshimin e paketës fiskale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot _____

Shkodër, më _____.____.2024

RELACION

“PËR CAKTIMIN E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË DHE SHESHE, NË TERRITORIN E BASHKISË SHKODËR”.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Shkodër në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë dhe funksioneve të saj, ka marrë nisëm të caktojë zona të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe, në territorin e Bashkisë Shkodër brenda juridiksionit, në pajtim me ligjin.

Baza ligjore:

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 23, pika 14, neni 54/germa k; Ligjit nr.8378, date 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 3 pika 28, neni 7 e vijues; Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar neni 14, neni 15; Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.89, datë 22.12.2022, “Për policinë bashkiake”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 07.04.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Udhëzimit nr.7, datë 10.06.2008 “Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë”, Paketa Fiskale Vjetore e Bashkisë Shkodër, si dhe referuar relacionit të përgatitur nga grupi i punës ngritur me Urdhërin nr.998, datë 08.07.2024, “Për ngritjen e grupit të punës me qëllim studimin dhe caktimin e vendparkimeve të automjeteve që do të bëhen me pagesë në rrugët/sheshet publike dhe tarifën që caktohet për to, në territorin e Bashkisë Shkodër”.

Si një nga prioritetet tona kryesore, Bashkia e Shkodrës po i kushton një vëmendje të veçantë transportit dhe lëvizjes së qytetarëve në përputhje me nevojat e komunitetit dhe qytetit. Ne kemi filluar të punojmë me disa aspekte të transportit, aktualisht ka përfunduar Plani i Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane (SUMP) e financuar nga Banka Evropiane e Investimeve, ERI ITA, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Shkodër, që parashikohet të zbatohet tërësisht gjatë një periudhe 10-vjeçare (disa masa do zbatohen më parë e disa më vonë, sipas prioriteteve) dhe lëvizjes bazuar në studimin e koncepteve dhe modeleve të lëvizjes të kryera për problematikat e transportit. Një nga çështjet më domethënëse është menaxhimi dhe organizimi i parkimit në qytetin e Shkodrës, qendrën e Shirokës si dhe plazhit të Velipojës.

Për shkak të sistemit infrastrukturor (kompozimi i sistemit rrugor), zhvillimeve demografike, flukseve turistike, problematikat e “pikut të trafikut”, synojmë të nxisim mënyrat alternative të transportit, duke menaxhuar dhe kontrolluar qarkullimin në akset kryesore rrugore të qytetit.

Në qytetin e Shkodrës siç janë miratuar nga ana këshillit të bashkisë, është bërë funksionale një rrjet kilometrik për pedalim si dhe një pjesë e madhe e qytetit përshkohet normalisht në këmbë.

Për një qytet të urbanizuar si Shkodra, parkimi në rrugë është një komponent thelbësor dhe jetik, i cili ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së banorëve, si dhe përmirësimin e lehtësimin e lëvizjes dhe orientimit të vizitorëve, turistëve, etj. Shkodra ka përjetuar ndryshime demografike dhe socio- ekonomike që kanë sjellë vëmendjen ndaj nevojës për rregullimin e parkimit, gjithashtu edhe nxitjen dhe zhvillimin e transportit multimodal dhe duke parandaluar problematikat me trafikun dhe lëvizjen e mjeteve. Parkimi, në rrugët që do të përshkruhen më poshtë u mundëson banorëve dhe turistëve të vizitojnë bizneset dhe zona të tjera të qytetit.

Parkimi, megjithatë, është një problem i ndërlikuar që ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin, lëvizshmërinë, aksesin, transportin urban dhe rajonal, cilësinë e mjedisit dhe përdorimin e hapësirës urbane. Strategjitë e politikave të parkimit që lidhen me Masterplanin e Shkodrës mund të inkurajojnë njerëzit të lëvizin sa më pak brenda qytetit me automjete, duke përmirësuar gjendjen e trafikut në rrugë dhe të uljen e ndotjes së mjedisit. Për të shfrytëzuar sa më mirë hapësirën ose zonën e parkimit për përdoruesit, oraret, destinacionet e vendndodhjet dhe për të akomoduar jo vetëm kërkesat e zënies, por edhe ato administrative dhe tregtare – menaxhimi, do të përcaktohen bazuar në kritere, rregulla dhe kufizime. Kjo do të mbështesë zhvillimin ekonomik, duke promovuar transportin multimodal dhe duke parandaluar problemet me trafikun dhe lëvizjen.

Për të arritur një ekuilibër midis ofertës dhe kërkesës për parkim është vendosur të aplikohet parkimi i kontrolluar. Kjo do të trajtojë çështje si mungesa e kapacitetit të parkimit të qytetit në zonat e biznesit, të cilat mund të pengojnë rritjen ekonomike dhe të shkaktojnë stres për shoferët që kërkojnë për të përfituar shërbimin e parkimit publik. Për më tepër, parkimi i kontrolluar mund të reduktojë trafikun urban.

1. Zonat e administrimit të parkimit në rrugë me pagesë (ZAP).

Zonat e administrimit të parkimit në rrugë me pagesë në territorin e Bashkisë së Shkodrës do të jenë zonat që përfshihen në sistemin e administruar nga instancat përkatëse në respekt të ligjit, nga Bashkia e Shkodrës.

Zonat tarifore, me qëllim vendosjen dhe vjeljen e tarifës së shërbimit të parkimit publik në rrugë me pagesë do të përfshijnë akset:

- Vendndodhjet me ngarkesën më të madhe me ndërveprime intensive tregtare, financiare, institucionale apo sociale;
- Një pjesë e rrjetit rrugor të kësaj zone mban/përcjell aktivitetin e administratës publike, qendrat e biznesit, bankat, institucionet kulturore dhe artistike, aktivitetin turistik, lokalet dhe njësitë e shërbimit, pikat kryesore në të cilat janë konstatuar problematika në parkimin e mjeteve, etj.;
- Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se hapësirat e parkimit në rrugë shfrytëzohen maksimalisht, sidomos gjatë mesditës kur kërkesat janë shumë më të mëdha se numri i vendeve të disponueshme.

❖ Rrugët dhe sheshet e destinuara për parkim publik në rrugë me pagesë propozojmë të jenë si më poshtë:

1. Bulevardi “Zogu i I-rë”.
2. Rruga “Studenti”.
3. Rruga “Qemal Draçini”.
4. Rruga “Martin Camaj”.
5. Rruga “Vilson”.
6. Bulevardi “Skënderbeu”.
7. Bulevardi “Bujar Bishanaku”.
8. Vendparkim nr. 1, në hyrje të qendrës së Shirokës.

9. Vendparkim nr. 2, në dalje nga qendra e Shirokës.
10. Vendparkimi aktual publik nr.1, në qendër të Velipojës.
11. Vendparkimi aktual publik nr.2, në rrugën “Pashko Selita”, Velipojë.

Në rrugët dhe sheshet e mësipërme ka rreth 1250 (njëmijë e dyqind e pesëdhjetë) vende për mjete që do të jenë me pagesë, nga rreth 3000 (tre mijë) vendparkime në total bazuar në studimin e bërë në dokumentin Plani i Lëvizshmërisë së Qëndrueshme Urbane (SUMP). Në këto shifra nuk përfshihen parkingjet sheshet e pallateve dhe në banesat private.

Për llogaritjen e hapësirës që aktualisht është e disponueshme për parkim (pra për të përcaktuar zonat e parkimit publik në rrugë me pagesë) bazohemi në këto kritere:

- a. Hapësirat e zëna nga zonat e ndalimit për shërbimet e transportit publik (stacionet e autobuzave);
- b. Hapësirat e zëna për vëndqëndrimet e taksive;
- c. Hapësirat e zëna për vëndqëndrimet e parkimit të rezervuar nga subjektet private.
- d. Hapësirat e zëna për vëndqëndrimet e parkimit të rezervuar të invalidëve.
- e. Hapësirat e zëna nga koshat e mbeturinave në rrugë;
- f. Hapësirat e nevojshme për kryqëzimet, duke konsideruar 5 m (minimalisht) nga fundi i parkimit, deri në distancën e fillimit të korsisë.

2. Ditët dhe orarët e qëndrimit dhe tarifat e shërbimit të parkimit në rrugë me pagesë.

Përsa më sipër, grupi i punës i ngritur me Urdhërin Nr.988, datë 08.07.2024 ‘Për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit në territorin e Bashkisë Shkodër’ propozon:

- a. Parkim të rezervuar për automjetet e personave me aftësi të kufizuar pa pagesë, në numër vendesh në % sipas parashikimeve ligjore.
- b. Parkimin me pagesë në rrugët dhe sheshet e shënuara më lart.
- c. Tarifat e parkimit me pagesë në rrugë do të jenë 50 (pesëdhjetë) lekë në orë sipas VKB nr.1 dt.22.01.2016 për autoveturat dhe 300 (treqind) lekë për autobuzët, vetëm në vendparkimet e Shirokës, pas ndryshimit të paketës fiskale.

- d. Parkimi me pagesë në zonat e propozuara si të tilla do të shtrijnë kohëzgjatjen si:
1. prej orës 08.00 deri në orën 16.00 në vendparkimet e qytetit të Shkodrës gjatë gjithë vitit, nga e Hëna në të Premte (e Shtunë dhe e Dielë pa pagesë);
 2. prej orës 10.00 deri në orën 22.00 në vendparkimet e Shirokës gjatë gjithë vitit nga e Hëna në të Dilë.
 3. prej orës 00.00 deri në orën 00.59 (24/7) gjatë sezonit veror (1 Qershor – 31 Gusht) në vendparkimet e plazhit të Velipojës nga e Hëna në të Dilë.
 4. Në këto zona do të vendosen tabela në gjuhën shqipe dhe në anglisht, e cila njofton qytetarët dhe turistët, për oraret përkatëse dhe tarifatat që do të zbatohen.
 5. Në të gjitha zonat e çdo kategorie përdorimi në rrugë, pas orareve të përcaktuara më sipër është parkim i lirë, pa pagesë.
 6. Përfshihen nga këto tarifa vendparkimet për personat me aftësi ndryshe, pasi sipas ligjeve të veçanta të aftësisë së kufizuar përfshihen nga çdo lloj detyrimi, si dhe vendparkimet e ambulancës dhe zjarrfikëses.

3. Kriteret për përcaktimin e Zonave të Administrimit të Parkimit (ZAP).


Zonat e administrimit të parkimit në territorin e Bashkisë së Shkodrës janë zona që përfshihen në sistemin e kontrolluar të administrimit të parkimit nga Bashkia.

3/1 ZAP konsiderohen zonat që plotësojnë kriteret sipas:

- a. Përcaktimeve të Kodit Rrugor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij: ku përfshihen të gjitha karakteristikat/normat teknike dhe funksionale që lidhen me përcaktimin e parkimit dhe ndërlidhjen e tij me elementet e rrugës ose jo.
- b. Planit të qarkullimit të mjeteve: ku përfshihen të gjitha mundësitë që ofron plani i lëvizjes në raport me karakteristikat/normat teknike të përcaktimit të vendeve të parkimit.
- c. Kushteve të infrastruktures rrugore: ku përfshihen kushtet fizike të infrastrukturës rrugore, e rikonstruktuar ose e parikonstruktuar dhe lidhja e saj me karakteristikat/normat teknike të përcaktimit të vendeve të parkimit.
- d. Kategorizimeve të rrjetit rrugor dhe zonat jashtë rrugë sipas shkallës/intensitetit të aktivitetit social ekonomik.

4 Zonat e Administrimit të Parkimit me pagesë në Bashkinë e Shkodrës (ZAP)

Harta Nr. 1. Rrugët e shënuara me ngjyrë portokalli, që do bëhen me pagesë në qytetin e Shkodrës.



MAPA DE
GRATIA BAZAR

RETEA

LELECE

LINE MARCATI
PENTRU PARCARE VEICULE

Harta Nr.2. Vendparkimet publike të vijëzuara me ngjyrë të kuqe, në plazhin e Velipojës.



Harta Nr. 3. Vendparkimi aktual nr. 1 dhe projekti i ndërtimit të parkingut publik nr. 2 në Shirokë, që do bëhen me pagesë .



Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 54 germa “k”, të ligjit nr.139/2015“Për vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshur; i propozojmë Këshillit të Bashkisë Shkodër:

Miratimin e projekt-vendimit “Për caktimin e zonave të administrimit të parkimit dhe tarifave të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe sheshe, në territorin e Bashkisë Shkodër”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!



Grupi i punës

z.Onid Bejleri - Kryetar

z.Lulzim Mashi - anëtar

z.Denis Lesha - anëtar

z.Elvin Brahimë - anëtar

z.Elton Myrtaj - anëtar

z.Andi Shkreli - anëtar

z.Pjerin Lazri - anëtar